PROF. KOLË PAPARISTO DHE BASHKËPUNËTORËT

TOPUZI L.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Biologjisë.

Sot jemi mbledhur për të kujtuar e nderuar figurat e shquara të shkencës e mësimdhënies së vendit tonë në fushën e Biologjisë. Ne përulemi me respekt ndaj profesorëve dhe kolegëve tanë, pjesa më e madhe e të cilëve nuk jetojnë më. Ata, me inteligjencën e tyre, përkushtimin në punë, pasionin, kulturën e plotë biologjike e më gjerë, korrektësinë e dashamirësinë ndaj kuadrovë të rinj dhe studentëve, patriotizmin e spikatur, kanë ndikuar fuqishëm në përgatitjen shkencore e edukative të shumë brezave kuadrosh dhe i kanë nxitur të ecin përpara në kualifikimin e vazhdueshëm, disa prej të cilëve drejt gradave e titujve më të lartë.

Prof. Kolë Paparisto lindi në qytetin e Elbasanit, në 8 nëntor 1914. Babai i tij ka qenë zanatçi. Mbasi mbaroi Liceun e Korçës me rezultate shumë të mira, vazhdoi dhe përfundoi studimet e larta për Biologji në Paris. Në vitet 1941-1943 punoi si mësues i shkencave Natyrore në shkollën Normale. Në vitin 1943 doli partizan dhe punoi në Qarkun e Elbasanit e për një periudhë kohe pranë shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në maj të vitit 1944, si delegat i Elbasanit, mori pjesë në Kongresin e Përmetit, ku u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Për formimin e tij, për aftësitë e tij organizuese, për ndjenjat patriotike e idetë përparimtare Kolë Paparisto u ngarkua me detyra e përgjegjësi të rëndësishme në fushën e arsimit e të shkencës. Në vitet 1945-1947 ka punuar fillimisht si kryetar dege në Ministrinë e Arsimit, më pas zëvendësministër. Në vitet 1949-1957 ka punuar

në Institutin e Shkencave me detyrën e kryetarit të tij. Në 1957, me krijimin e Universitetit të Tiranës, emërohet zv/Rektor për anën shkencore, deri në vitin 1967, në të njëjtën kohë kryente detyrën e përgjegjësit të Katedrës së Botanikës në Fakultetin e Shkencave Natyrore. Gjatë kësaj kohe atij i jepet titulli Profesor. Në vitet 1967-78 ka punuar në Fakultetin e Shkencave Natyrore si pedagog e përgjegjës i Katedrës së Botanikës. Në vitin 1978, me krijimin e Qendrës së Kërkimeve Biologjike, pranë Akademisë së Shkencave (sot Instituti i Kërkimeve Biologjike), kalon pranë saj si përgjegjës i Sektorit të Florës, detyrë të cilën e mbajti deri më 27 gusht 1980, kur u nda nga ne. Në vitin 1972, me krijimin e Akademisë së Shkencave, për merita të shquara në fushën e Shkencës e Arsimit, K. Papariston e gjejmë si anëtar të Akademisë dhe përgjegjës të seksionit të Shkencave Natyrore. Ka qenë i zgjedhur për disa legjislatura deputet i Elbasanit. Ai është Mësues i Popullit, mban Çmimin e Republikës dhe disa urdhëra e medalje të luftës e të punës.

Prof. K. Paparisto e kishte në metodën e tij punën në grup, për këtë, ai shpesh në biseda theksonte 'unë punoj me shokët'. Kështu punën e tij shkencore në drejtime të ndryshme në fushën e botanikës, ai e realizoi me shokët e tij, disa prej të cilëve i pati studentë që i drejtoi, udhëhoqi dhe i bëri të aftë të marrin mbi vehte detyra të rëndësishme shkencore në bashkëpunim ose individualisht. Falë kësaj përvoje dhe aftësive, përkushtimit e seriozitetit në punë, mjaft prej tyre u bënë figura të shquara në fushën e shkencës dhe të mësimdhënies.

Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor Ilia Mitrushi u lind në Panarit të Korçës, ku mbaroi dhe shkollën fillore. Shkollën e mesme dhe të lartë i kreu në Vienë; studimet e larta i përfundoi në vitin 1931 në Fakultetin e Shkencave Pyjore, ku u diplomua me titullin Inxhinier Pyjesh. Për shumë vite ka punuar si specialist e përgjegjës seksioni në Ministrinë e Ekonomisë Kombëtare, pastaj si inxhinier pyjesh e të Pyjeve. Në vitin 1950 emërohet punonjës shkencor në Institutin Shkencave dhe në vitet 1957-1968 punonjës shkencor në Katedrën e Botanikës, i ngarkuar dhe me detyrën e përgjegjësit të Sektorit të Florës. Përveç artikujve të shumtë

shkencorë që botoi në Buletinin e Shkencave të Natyrës dhe organe të tjera, ai botoi dhe dy librat e tij të nje vlere të madhe që janë: Drurët dhe Shkurret e Shqipërisë, si dhe Dendroflora e Shqipërisë; gjithashtu, është bashkëaytor në botimin e Florës së Evropës me qendër në Kembrixh, dhe bashkëautor i vepërs Atlasi i Florës së Evropës, me qendër në Helsinki. Në vitin 2005, Akademia e Shkencave të Shqipërisë mundësoi edhe botimin e monografisë Frytet dhe Farat e Drurëve dhe Shkurreve të Shqipërisë, ku Z. Mitrushi është bashkëautor i parë.

Prof. Mustafa Demiri kreu studimet e larta në fushën e biologjisë në Sofje dhe i përfundoi në vitin 1951. Në vitin 1952 emërohet punonjës shkencor në Institutin e Shkencave dhe në vitin 1957, punonjës shkencor në Katedrën e Botanikës. Në vitin 1965 emërohet përgjegjës i Kopshtit Botanik të Universitetit të Tiranës deri në vitin 1985 kur u nda nga ne.



Prof. Xhafer Qosja, kreu studimet e larta në degën Biologji-Kimi. Në vitin 1952 emërohet punonjës shkencor në Institutin e Shkencave dhe në vitin 1957 deri në vitin 1968, punonjës shkencor në Katedrën e Botanikës. Në vitin 1968 emërohet përgjegjës i Katedrës së Botanikës pranë Institutit të Lartë Bujqësor deri në vitin 1989 kur del në pension. Në vitin 1996 u nda nga ne.

Prof. Paparisto ka dhënë kontribut të shquar në fushën e organizimit, të zhvillimit e kërkimit shkencor në vendin tonë, në ngritjen e institucioneve shkencore të specializuara. Në këtë drejtim është shumë e rëndësishme puna e tij si kryetar i Institutit të Shkencave, në vitet 1949-57, që në atë kohë kryente edhe funksionet e një Akademie të Shkencave. Me një punë vetmohuese e me formimin e pjekurinë e tij shkencore riorganizoi të gjitha strukturat e Institutit, forcoi seksionet ekzistuese dhe ngriti disa seksione të reja (Muzeun Arkeologjik-Etnografik, Institutin e Gjuhësisë dhe Historisë, Arkivin Kombëtar, Bibliotekën Kombëtare, Shërbimin Hidrometeorologjik, Muzeun e Shkencave Natyrore), por më e rëndësishme është se ai punoi, ndihmoi e këmbënguli që i gjithë

aktiviteti të vihej mbi baza sa më të shëndosha shkencore. Për këtë arsye ai insistonte në planifikimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, në hartimin e metodikave të hollësishme dhe kontrollin periodik të rezultateve. Një veprimtari të tillë ai e zhvilloi po me atë këmbëngulje edhe si zv/Rektor i Universitetit të parë të Tiranës, në vitet 1957-1967, ku mbulonte anën shkencore të tij.

Në fushën e specialitetit të ngushtë të shkencave botanike, Prof. K. Paparisto, që në hapat e para të punës në Institutin e Shkencave, e ndjeu domosdoshmërinë e njohjes dhe studimit të florës spontane. Flora e Shqipërisë ka filluar të studiohet aty nga mesi i shekullit të 19 nga botanistë të huaj, kryesisht austriakë, gjermanë, hungarezë e italianë. Gjatë disa dekadave ata grumbulluan shumë material, të cilin e kanë shpërndarë në muzeumet e Europës. Studimet kanë vazhduar deri në 10-vjeçarët e parë të shekullit 20. Pas çlirimit, puna kërkimore lidhur me florën e vendit tonë u muarr në dorë kryesisht nga botanistët tanë. Prof. Paparisto që në vitin 1949 (në Institutin e Shkencave) shtroi detyrën për hartimin e plotë të Florës së Shqipërisë dhe filloi sistematikisht grumbullimin e materialit. Së bashku me M. Demirin, Xh. Qosen, L. Topuzin, I. Mitrushin, E. Balzën etj., mbështetur në një metodike shumë të rreptë e shkencore, u organizua grumbullimi i literaturës së huaj të nevojshme, sidomos të vendeve fqinje dhe Florës së Europës. Filloi në ato vite botanizimi i gjithë territorit të Shqipërisë, që nga zonat bregdetare e deri në malet tona të larta. Organizimi dhe realizimi i ekspeditave botanike ka qenë një punë me përgjegjësi, e lodhshme, për rrjedhojë kërkonte përkushtim. Ata, për 30 vjet, nga 1-2 muaj në vit, kanë kaluar në ekspedita që nga Vermoshi në Konispol, që nga bregdeti në Gramoz, duke u bërë njohësit më të mirë të Florës së vendit tonë dhe njohës të florës së vendeve fqinje.

Një punë voluminoze është realizuar për përpunimin e bimëve të mbledhura, sistemimin dhe ruajtjen e tyre e konkretizuar me ngritjen e Herbarit Kombëtar, që është një arritje e papërsëritëshme, me vlera të mëdha shkencore, që sot me shpërbërjen e Institutit të Kërkimeve Biologjike rrezikohet të dëmtohet, ndoshta edhe më shumë. Në të ruhen rreth 130 000 ekzemplarë bimorë, që përfaqësojnë rreth 3200 specie të Florës së Lartë nga i gjithë territori i vendit. I gjithë ky angazhim në terren është pasuar me një punë të madhe, shumë të hollë e shkencërisht shumë të saktë laboratorike, me përcaktimin sistematik të specieve, që është dhe puna më e vështirë dhe më me përgjegjësi në hartimin e florave. Për këtë qëllim, gjatë dekadave të punës janë bërë konsultime me florat e huaja, janë shkëmbyer informacione dhe kanë pasur korrespondencë me shkencëtarë të huaj; gjithashtu kanë vizituar dhe herbare të huaja si në Paris, Vjenë etj., për të konsultuar materialet bimore që ruhen në Herbarin tonë me ato të institucioneve botanike të specializuara të vendeve të tjera. Në

të njëjtën kohë është bërë një studim kritik i materialeve të botuara nga të huajt për Florën e Shqipërisë

Pas një periudhe përgatitore pak a shumë të gjatë u krijua Redaksia e Hartimit të Florës me K. Papariston, M. Demirin, Xh. Qosen dhe I. Mitrushin, në krye të të cilës, si redaktor i përgjithshëm përgjegjës qendronte Prof. Paparisto. Filloi puna për shkrimin e Florës në 4 volume, një vepër themelore në historinë e zhvillimit të shkencave biologjike të vendit tonë. Pas një pune të pandërprerë, të madhe u arrit suksesi i madh, përfundoi vëllimi i parë e i dytë i Florës së Shqipërisë. Në bazë të metodikës së hartuar dhe bazës materiale të grumbulluar në dekada u botua dhe vëllimi i tretë. Pas humbjes së tyre përfundimi i kësaj vepre madhore, në rrugën e hapur, u mbeti detyrë kuadrove të reja që ata i përgatitën, i udhëhoqën dhe i ndihmuan pa ndërprerje.

Pas humbjes së Prof. Paparistos, drejtimin e Redaksisë për vëllimin e dytë e të tretë e mori Prof. Qosja, por për punën e bërë më parë mbeten si anëtarë të këtyre vëllimeve edhe Prof. Paparisto e Prof. Demiri. Në të njëjtën kohë për këto vëllime punuan nxënësit e bashkëpunëtorët tyre Jani Vangjeli, Babi Ruçi, Alfred Mullai. Për hartimin e vëllimit të dytë punoi edhe bashkëpunëtori i vjetër shkencor Emin Balza, i cili për dekada ka qenë bashkëpunëtor i tyre dhe ka dhënë një kontribut të veçantë në grumbullimin dhe sistemimin e materialeve të mbledhura. Emin Balza në punën e tij si botanist pranë Katedrës së Botanikës është dalluar edhe për përgatitjen e tij shkencore, seriozitetin dhe përkushtimin e tij në punë. Ai në bashkëpunim me Prof. Murat Xhulaj, hapi për herë të parë fushën e studimit të kërpudhave. Ka botuar me bashkëautor monografinë 'Bimët mjaltore të Shqipërisë' tekste për shkollat e larta e të mesme, shumë artikuj shkencor etj.

Flora e Shqipërisë, përveç përmbushjes së një kërkese madhore për shkencën tonë të re, lidhet dhe me saktësimin e shumë aspekteve sistematike e ekologjike mbi florën tonë, që shkenca botërore, në disa aspekte, i njihte në mënyrë të gabuar, lidhet edhe me zbulimin për herë të parë të disa specieve endemike shqiptare të panjohura nga shkenca botërore, disa prej të cilave cilësohen sot në literaturën shkencore botërore edhe në emrin e Kolë Paparistos.

Në parathënien e vëllimit të parë, ata me ndërgjegjen e shkëncëtarit të kompletuar e modest thonë: '*Njohja e plotë e të gjitha specieve bimore të vendit dhe e tipareve të tyre është një punë e gjatë, që kërkon përpjekjet e shumë brezave, prandaj kjo punë fillestare nuk mund të mos paraqitet me mungesa e të meta, të cilat do të plotësohen me kërkimet e nevojshme dhe me ndihmën e studiuesve e të vëzhguesve të shumtë të natyrës sonë*'.

Gjatë punës për hartimin e Florës së Shqipërisë, ata i paraprinë asaj me botimin e disa veprave. Në vitin 1955 u botua vepra 'Drurët e shkurret e Shqipërisë' nga Ilia Mitrushi dhe në 1961 'Flora e Tiranës', nga K. Paparisto, M. Demiri e Xh. Qosja , që janë veprat e para shkencore floristike e që ndihmuan në atë kohë (e që vazhdojnë) në njohjen e studimin e bimëve tona spontane. Hartimi i këtyre veprave mbushi një boshllëk në këtë fushë dhe një nevojë për përgatitjen e botanistëve të rinj, duke ndihmuar njëkohësisht mësuesit e biologjisë dhe punonjësit e pyjeve. Duke qenë vepra të mirëfillta shkencore, origjinale, shumë serioze e me vlera praktike, autorët e tyre u nderuan me Çmimin e Republikës.

Nën kujdesin, këmbënguljen, dhe udhëheqjen e Prof. Paparistos, u organizua kualifikimi i kuadrove të Katedrës. Vlen të theksohet se M. Demiri Xh. Qosja që në vitin 1963 e më pas Prof. Stefo Kongjika, qenë ndër punonjësit e parë, jo vetëm në fushën e Botanikës, por në gjithë Fakultetin e Shkencave Natyrore që mbrojtën doktoratën, falë përgatitjes së tyre serioze, përkushtimit dhe punës disavjeçare.

Prof. Ilia Mitrushi, si njohës i shkëlqyer i pylltarisë shqipëtare e më gjerë, dijet dhe punën e tij shumëvjeçare i pasqyroi, veç të tjerave në botimin e disa veprave fondamentale. Përmendim 'Drurët dhe Shkurret e Shqipërisë', 'Dendroflora e Shqipërisë', bashkëautor i Atlasit të Florës së Evropës; dhe së fundi 'Frytet e Farat e Drurëve dhe Shkurreve'. Me këto vepra ai u bë i njohur edhe në fushën floristike evropiane, për rrjedhojë ai qe konsulent i Florës së Evropës për Shqipërinë. Ai ka botuar një mori artikujsh në Buletinin e Shkencave Natyrore dhe të Bujqësisë.

M. Demiri mbrojti punimin 'Mbi biologjinë, dinamikën e prodhimin e kullotave'. Qendra e studimit të tij qe Dumreja e Polisi. Në këtë punim atë e ndihmoi profesor Larin në Leningrad (Petërburg) ku ai shkoi disa herë. Studimi ka vlera të padiskutueshme shkencore, por është edhe një ndihmesë shumë e vyer praktike për trajtimin në përgjithësi të kullotave tona. Prof. Demiri ka botuar një seri veprash me vlera shkencore e praktike. Përmendim 'Përcaktuesi i bimëve', 'Flora eskursioniste e Shqipërisë', 'Bimët Ngjyruese', 'Bimët e Egra dhe të Dobishme' etj. Ai ka botuar shumë artikuj shkencorë në Buletinin e Shkencave Natyrore e ato të Bujqësisë.

Xh. Qosja mbrojti punimin 'Barërat e këqija të kulturave bujqësore'. Për herë të parë në këtë punim jepen të dhëna të përgjithëshme për dëmet që shkaktojnë, veçoritë biologjike etj. Ky punim me vlera shkencore teorike është dhe një ndihmesë për punonjësit e bujqësisë. Prof. Qosja ka botuar një seri veprash me vlera shkencore e praktike. Përmendim Barërat e Këqija të Shqipërisë, Flora dhe Vegjetacioni i Shqipërisë Juglindore, Flora e Korçës,

Bota e Mikroorganizmave etj. Ai ka botuar shumë artikuj shkencorë në Buletinin e Shkencave Natyrore e ato të Bujqësisë.

Në vitin 1964 një grup specialistësh: K. Paparisto, M. Demiri, I. Mitrushi etj, u caktuan të organizonin punën për ngritjen e Kopshtit Botanik të Tiranës. Tani që Kopshti ka mbaruar e ka marrë formën e tij të plotë, ne vemë re edhe një herë aftësitë e mëdha profesionale të profesorëve tanë. Kjo duket nga vendi i zgjedhur me një variacion të mahnitshëm, pozicion që dominon Tiranën, sodit Malin e Dajtit, ndodhet pranë Liqenit Artificial të Tiranës, si dhe në zbatimin e parimeve fitogjeografike moderne në vendosjen e bimësisë për një kopësht botanik; dhe e gjithë kjo rreth 100 m mbi niveline e detit.

Kopshti Botanik që zë rreth 14 ha, toka e të cilit duhej sistemuar e pasuruar tërësisht sepse në të do të mbilleshin bimë nga tërë Shqipëria, kërkonte nje drejtues kompetent, të apasionuar dhe punëtor, dhe si të tillë Prof. Paparisto zgjodhi botanistin e shquar Mustafa Demiri. Ideja e planit të përgjithshëm të ndërtimit të Kopshtit si e përmendëm më lart, qe e grupit të specialistëve, por për zbatimin e korrigjimin e tij një meritë të veçantë ka M. Demiri. Ai për vite të tëra udhëhoqi personalisht ekspeditat në tërë vendin për grumbullimin e bimëve të gjalla e farave dhe ndiqte mbjelljen e mbarëvajtjen e tyre. Në këtë punë ai bashkëpunoi me dendrologun Vasil Shqau, e u ndihmua nga bashkëpuntori shkencor Eshref Palikuqi, agronomi Jorgo Talo e kryepunëtori Halil Bejko. Duhet theksuar se në ndërtimin e Kopshtit Botanik ndihmuan me qindra studentë e pedagogë të Universitetit të Tiranës gjatë muajve të punës fizike.

Vlera e një shkencëtari midis të tjerave përcaktohet dhe nga puna e bërë për përgatitjen e kuadrit që do ta zëvendësojë. Vemë në dukje me kënaqësi se bashkëpuntorja e Profesor Demirit, profesoreshë Liri Dinga ka mbi 20 vjet që drejton Kopshtin Botanik me shumë aftësi, përkushtim e pasion.

Prof. Paparisto nxiti një punë sistematike shkencore në disa drejtime me vlera teorike e praktike. Me bashkëpunëtorin e vjetër shkencor, Emin Balza, drejtoi punime interesante mbi polenizimin e kryqëzuar me anë të bletëve që u pasqyrua në monografinë 'Bimët mjaltore të Shqipërisë'. Me shumë interes janë rezultatet në marrjen e rendimenteve të larta, duke përdour përzgjedhje të caktuara foragjeresh ose duke futur specie të reja dhe në toka që konsideroheshin të varfëra i ndihmuar nga Abedin Braçe. Në fushën e fiziologjisë bimore, nën drejtimin e profesor Stefo Kongjikës, e ndjekur nga Efigjeni Dhima e Dhimitër Shuqja, u ngrit një punë eksperimentale e gjerë në përdorimin e oligoelementëve në praktikën bujqësore për shtimin e rendimentit të kulturave të dobishme dhe u propogandua domosdoshmëria e zgjerimit edhe në fushën e oligoelementëve në konceptin e plehut kimik. Në

këto studime ka punuar me pasion edhe kimistja, analistja e talentuar Nadire Konçi. Punonjësi i dalluar shkencor, Sotir Angjeli, ngriti një punë shumë interesante eksperimentale për bimët mjeksore i ndihmuar nga agronomi Haki Ahmataj. Rezultatet e këtyre punimeve janë pasqyruar në monografi e në dhjetra artikuj shkencor në Buletinin e Shkencave Natyrore e ato të Bujqësisë.

Prof. Paparisto i jepte rëndësi të madhe proçesit të formimi e të kualifikimit të kuadrit të ri, si në fushën e arsimit të lartë dhe në atë të prodhimit. Ai synonte t'i komunikonte bashkëpuntorëve dëshirën për të shkuar gjithmonë përpara në shkencën e specialitetit, nevojën e një informimi të rregullt e sa më të saktë shkencor dhe shfrytëzimin e burimeve bibliografike, gjuhëve të huaja, arritjet e shkencës botërore, duke çarë me sa mundte edhe kufizimet e kohës për këto probleme. Ai ndihmoi shumë punonjës për marrjen e gradave shkencore e titujve, për t'i aftësuar ata për punë të pavarur shkencore e mësimore. Ai i jepte rëndësi të madhe qëndrimit korrekt e të ndërgjegjshëm ndaj punës, institucionit të punës, planifikimit e avancimit të veprimtarisë kërkimore shkencore, shtrimit të metodikës së punës e zbatimit të saj, vjeljes e interpretimit të rezultateve, nxjerrjes së përfundimeve shkencore etj., që janë pasqyrë e fizionomisë së një shkencëtari.

Këto karakteristika i gjejmë edhe tek bashkëpunëtorët e tij. Ata ishin puntorë të palodhur, kërkues si ndaj vetes e të tjerëve, seriozë e shumë korrektë. Me këto cilësi ata drejtuan e udhëhoqën disa kuadro të shkollës së lartë e të prodhimit në aktivitete të ndryshme kërkimore-shkencore, disa prej të cilëve mbrojtën doktoratat.

E palodhur ka qenë puna e Prof. Paparistos në organizimn dhe ngritjen e Institutit të Lartë 2-vjeçar në vitin 1946, i pari institucion i arsimit të lartë në vendin tonë, dhe më pas të Universitetit të Tiranës, kësaj vatre të pashuar të zhvillimit e të dijes, të kulturës, të shkencës e të zhvillimit mendor shkencor në përgjithësi, që ne i festojmë këtë vit 50 vjetorin e themelimit.

Me përgatitjen e gjerë teorike e aftësitë e rralla organizative, ai ndihmoi në organizimin e brendshëm të shkollës së lartë: të katedrave e fakulteteve, në hartimin e planeve mësimore e të programeve, sidomos të shkencave biologjike, në hartimin e teksteve e ngritjen e laboratorëve, në krijimin e traditës mësimore e shkencore në katedra.

Lënda e tij kryesore ishte Sistematika e Bimëve të Larta, për të cilën ai punoi shumë dhe arriti ta vendosë ndër disiplinat e rëndësishme të degës, për rëndësinë që ajo ka në njohjen e botës bimore në përgjithësi e të vendit tonë në veçanti. Prof. Paparisto, duke vlerësuar lart rolin e teksteve mësimore për përgatitjen e kuadrove të reja, ishte ndër të parët në universitet që hartoi

tekstin Sistemtika e Bimëve të Larta. Duhet theksuar se ai tekst kishte një origjinalitet të spikatur, sepse aty përfshihej jo vetëm kultura e gjerë shkencore e tij në fushën e botanikës, por edhe njohja e florës së vendit tonë. Këtë lëndë tani vazhdon ta japë nxënësi e bashkëpunëtori i tij, Prof. Murat Xhulaj.

Në institutin 2-vjeçar ai zhvilloi edhe disiplinën Evolucioni dhe Darvinizmi, një disiplinë komplekse, me aspekte e interpretime të shumta e të gjithanëshme ideologjike, të cilat për kohën kur u zhvilluan, Paparisto diti t'i përballojë me sukses, aq më shumë kur për atë disiplinë mungonte çdo lloj teksti e nuk kishte asnjë traditë si mësimore ashtu edhe shkencore.

Për gjithë këto merita Prof. Paparisto është nderuar me titullin e lartë Mësues i Popullit.

Kontribut me vlerë kanë dhënë në zhvillimin e arsimit tonë, veçanërisht atij të lartë, edhe profesorët: S. Mborja, S. Kongjika, M. Demiri, Xh. Qosja, L. Topuzi dhe E. Balza. Falë përgatitjes së plotë e të gjithanëshme, njohjes me organizimin e shkollave të larta në vendet e tjera, ata janë përpjekur në hartimin e përmirësimin e vazhdueshëm të planeve mësimore të degës Biologji-Kimi, duke e përmirësuar vazhdimisht si strukturën, ashtu edhe futjen e disiplinave të reja bashkëkohore. Këtu ka pasur gjithmonë rëndësi pasurimi i vazhdueshëm i programeve të lëndëve botanike dhe të disiplinave të tjera dhe rifreskimi me të rejat shkecore. Meritë e veçantë, veç të tjerave, ishte se hartuan për herë të parë tekstet universitare bazë të lëndëve botanikë, si 'Botanika e Përgjithëshme' (Mborja), 'Gjeografia e Bimëve' (Demiri), 'Fiziologjia e Bimëve' (Kongjika), 'Bimët e Ulëta' (Balza) etj.

Në këtë përvjetor nuk mund të mos përmendim kuadrin ndihmës, një pjesë e të cilëve nuk jetojnë më, të cilët kanë pasur rol të rëndësishëm e të pazëvendësueshëm në punën kërkimore-shkencore e të mësimdhënies në degën e biologjisë. Në shumë nga studimet dhe botimet e mësipërme ata kanë dhënë e ndihmesën e tyre të çmuar; këtu përmendim Angje Dukën, punonjësen e talentuar të Herbarit, kolektorin e papërtuar Vangjel Tartari, laboranten e përpiktë Donika Mema, skicografët e kujdesëshëm Fiqiri Karapici e Pjerin Shala etj.

Ne, si ish studentë e bashkëpuntorë për një kohë të gjatë me Profesorët tanë, përgëzojmë nismëtarët e këtij takimi. Profesor Paparisto dhe bashkëpunëtorët e tij janë figura të nderuara të vendit tonë për kontributin që kanë dhënë në shkencat biologjike dhe botanike në veçanti, si dhe zhvillimin e arsimit tonë, veçanërisht atij të lartë. Ne do t'i respektojmë e nderojmë ata vazhdimisht, përveç të tjerave që përmendëm më lart, edhe për edukatën, në kuptimin e gjerë të fjalës, që ata na dhanë.